



- Të Reja ▾Policia e Shtetit ▾Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptarShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjet e policisëVideo
- Programi i transparencës ▾KontaktDenonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore të Policisë ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾
- DonacioneRubrika Policimi në Komunitet ▾Përmbledhja JavorePër sinjalizimin

Breaking News: DVP Elbasan/Vihet në pranga 1 shtetas, procedohen në gjendje të lirë 4 shtetas dhe vijon puna për kapjen e 1 tjetri, për vepra të ndryshme penale

Durrës/Vihen në pranga 3 autorë të dyshuar veprash të ndryshme penale

DVP Shkodër/Vihet në pranga 1 shtetas dhe procedohen në gjendje të lirë 4 të tjerë, autorë të dyshuar për vepra të ndryshme penale

DVP Vlorë/Procedohen penalisht 3 shtetas dhe punohet për kapjen e 1 tjetri, autorë të dyshuar për vepra të ndryshme penale

Kukës – Procedohet pebalisht 1 shtetas, për veprën penale “Plagosja e rëndë nga pakujdesia”



Lajmet

10/01/2024

DVP Elbasan/Vihet Në Pranga 1 Shtetas, Procedohen Në Gjendje Të Lirë 4 Shtetas Dhe Vijon Puna Për Kapjen E 1 Tjetri, Për Vepra Të Ndryshme Penale

DVP Elbasan/Vihet në pranga 1 shtetas, procedohen në gjendje të lirë 4 shtetas dhe vijon puna për kapjen e 1 tjetri, për vepra të ndryshme penale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Cërrik arrestuan në flagrancë shtetasin H. K., 63 vjeç, banues në Cërrik, pasi ka ushtruar dhunë ndaj djalit të tij.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Elbasan referuan materialet procedurale në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin S. T., banues në fshatin Shushicë, pasi u konstatua nga shërbimet e Policisë, duke kryer punime ndërtimi, pa leje.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Gramsh referuan materialet procedurale në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin M. D., 20 vjeç, banues në fshatin Tërvol, pasi në lagjen “Holta”, për motive të dobëta, ka kanosur me fjalë dhe ka goditur me sende të forta, një bashkëmoshatar.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Librazhd referuan materialet procedurale në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin A. B., 47 vjeç, banues në Librazhd, pasi shërbimet e Policisë gjetën në banesën e tij dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale, një sasi municioni luftarak.

Specialistët e Qarkullimit Rrugor referuan materialet procedurale në Prokurori për shtetasen D. K., 35 vjeçe, pasi në fshatin Gjyralë, ka humbur kontrollin mbi automjetin që drejtonte dhe si pasojë automjeti është përplasur me një shtyllë. Nga përplasje është dëmtuar shtetasja D. K., e cila është në kujdesin e mjekëve, jashtë rrezikut për jetën.

Specialistët për Hetimin e Krimeve Kibernetike shpallën në kërkim shtetasin B. B., 31 vjeç, banues në Librazhd, pasi dyshohet se ka keqpërdorur të dhënat e një 26-vjeçareje, duke krijuar profile false në rrjetet sociale, si dhe e ka përndjekur këtë shtetase.

-Në vijim të informacionit paraprak të dhënë ditën e djeshme, se në lagjen “Çlirimi”, shtetasi B. M., 37 vjeç, banues në Elbasan, për shkak të gjendjes së rënduar psikologjike, ishte vetëhedhur nga lartësia e pallatit ku banonte, informojmë se pavarësisht ndërhyrjes së shërbimeve mjekësore, për shkak të dëmtimeve të rënda, 37-vjeçari ka humbur jetën.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Durrës/Vihen në pranga 3 autorë të dyshuar veprash të ndryshme penale